



**Data: 07/06/2024**

**PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS - MALL  
PROCEDURË E HAPUR MBI KUFIRIN E LARTË MONETAR  
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE  
PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “FURNIZIM VENDOSJE IMPIANT I RI SHPËRNDARËS 6KV, PËRMIRËSIMI I MBROJTJEVE RELE ME SISTEM TË MONITORIMIT TË QARKUT TË STAKIMIT DHE INTEGRIMI I SKEMËS SË RE NË SCADA TË HEC KOMAN”.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): PAJISJE TË NDRYSHME -39300000-5.**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 108,711,000 (Njëqind e tetëmilion e shtatëqind e njëmbëdhjetëmijë) Lek, pa TVSH ose 1,082,994.62 (Njëmilion e tetëdhjetë e dymijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër pikë gjashtëdhjetë e dy) Euro pa TVSH.**

***Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 07/06/2024 është 100.38 Lekë/Euro***

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

*a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

*b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

**Argumentimi:**

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82, “Formulari përmbledhës i vetdeklarimet” dhe Nenit 83 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i

ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar.

Në Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” citohet: “*Autoriteti Kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël*”, Në Nenin 82, të LPP, i ndryshuar, “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik*”.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):** me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, i ndryshuar, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në dispozitat e legjislacionit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. VKM-së nr.922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”.

Duke marrë në konsideratë specifikën e mallrave objekt procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet te ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për tre vitet e fundit financiare të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e fondit limit.

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit.

*Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:*

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Duke marrë në konsideratë kontratën objekt prokurimi është menduar se vlera e kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar me kontratat e ngjashme të jetë brenda vlerës kufi të përcaktuar në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor ka sigurinë dhe besueshmërinë që operatori ekonomik ofertues do realizojë me sukses kontratën objekt prokurimi.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi ose Distributor i Autorizuar për pajisjet dhe shërbimet që do të ofrojë.

- ✚ Impianti 6 Kv;
- ✚ Sistemi i monitorimit të qarkut të stakimit;
- ✚ Integrimi në sistemin Scala 250 të kontroll monitorimit dhe vizualizimit në këtë sistem.

*Dokumentacioni duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet*

*autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit.*

**Argumentimi:** Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e autorizimeve të prodhuesve ose distributorëve se operatorët ekonomikë janë të autorizuar nga prodhuesi apo distributori i autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij:

- Minimumi 2(dy) Inxhinier Elektrik/Elektronik të certifikuar nga prodhuesi/ institucione të autorizuar për sistemet e kontroll monitorimit (në përputhje me specifikimet teknike).
- Minimumi 2(dy) Inxhinier Elektrik/Elektronik të certifikuar nga prodhues/ institucione të autorizuar për mbrojtjet rele.

**Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:**

- Kontratë pune të vlefshme;
- Certifikatat e mësipërme të vlefshme;
- Diploma;
- Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për të paktën Prill 2024 – Maj 2024.

**Shënim: AK do të lejoj që 1(një) Inxhinier të ketë më shumë se një Certifikim.**

**Argumentimi:** Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. KESH sh.a, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

**Konkretisht:**

✚ Duke qënë se disa nga detyrat që operatori ekonomik ofertues duhet të realizojë janë edhe integrimi në SCADA të HEC Koman i sinjalizimit dhe kontrollit të impiantit 6 kV, integrimi i sistemit të monitorimit të qarkut të stakimit dhe sinjaleve të reja të çelësave 245 kV, është e domosdoshme që të garantohet ndëryrja në sistemin SCADA, pasi është një infrastrukturë kritike për operimin e HEC Koman. Sa më sipër operatori ekonomik ofertues për realizimin me sukses të kësaj kontrate duhet të vërtetojë që ka në staf punonjës të trajnuar për sistemet e kontroll monitorimit të HEC Koman.

✚ Në objekt të specifikimeve teknike është përcaktuar që sistemi i monitorimit të qarkut të stakimit do të integrohet në relet ekzistuese të mbrojtjes së agregateve. Operatori ekonomik duhet të realizojë punimet për parametrizimin e inputeve të reja dhe konfigurimin e outputeve me protokoll IEC104, për ndërfaqe me sistemin e kontroll – monitorimit, tek relet e mbrojtjes ekzistuese. Sa më sipër operatori ekonomik ofertues për realizimin me sukses të kësaj kontrate duhet të vërtetojë që ka në staf punonjës të trajnuar nga prodhues/institucione të autorizuar për mbrojtjet rele.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit/ve, të përkthyer në gjuhën shqipe në pjesët ku përcaktohen specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi, me të dhënat dhe karakteristikat teknike, në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike. Katalogët duhet të jenë të verifikueshëm në website të tyre përkatës.

**Argumentimi:** Kërkesa për paraqitjen e katalogut/ëve është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar, si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat **ose ekuivalentet e tyre**, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- ISO 9001 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”;
- ISO 45001 “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”;
- ISO 50001 “Sistemi i menaxhimit të energjisë”;

**ISO 9001 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”** - Ky standard është i nevojshëm për certifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rrisqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse mallrat e ofruar janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve.

**ISO 45001 “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”** - Ky standart është i nevojshëm për ndërgjegjësimin e gjithë personelit të shoqërisë në lidhje me masat e mbrojtjes së shëndetit, sigurisë dhe konsultimit të punësuarve për vlerësimin e rrisqeve të shëndetit dhe sigurisë në punë.

**ISO 50001 “Sistemi i menaxhimit të energjisë”** – Ky standard është i nevojshëm për stimulimin e kontraktorëve për të gjetur mënyra në identifikimin e mundësive për të reduktuar konsumin e energjisë, duke konsideruar përfshirjen e stafit në këtë proces.

**Argumentimi:** Kërkesa në lidhje me këto çertifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

**2.3.6** Operatori ekonomik duhet të paraqesë propozim teknik nga prodhuesi, bazuar në specifikimet teknike për impiantin 6kV.

**Argumentimi:** Kërkesa në lidhje me propozim teknik nga prodhuesi është kërkuar pasi:

Impiantet shpërndarës të tensionit të mesëm përbëhen nga shumë pajisje elektrike të asbluara për të përmbushur të gjitha funksionet dhe qëllimet e përdorimit. Për të njëjtin funksion prodhues të ndryshëm japin zgjidhje të ndryshme sipas teknologjisë që përdorin. Me qëllim njohjen në detaje të specifikimeve të të gjithë elementëve përbërës, për të garantuar përputhshmërinë me specifikimet teknike, prodhuesi duhet të hartojë një propozim teknik të ndërtimit të impiantit me elementët përbërës që do të përdoren. Në këtë mënyrë krijohet bindja tek Autoirrteti Kontraktor që produkti që do të furnizohet do të plotësojë të gjitha kërkesat sipas specifikimeve teknike dhe që prodhuesi ka kapacitetet teknike për të projektuar dhe prodhuar impiante të tilla të një niveli teknologjik të lartë.

*Të gjitha dokumentet duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.*

**Shënim:** Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

**Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.**

### **I. Argumentimi i specifikimeve teknike:**

*Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, sipas parashikimeve të nenit 36 të Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.*

Specifikimet teknike për impiantin 6 kV në HEC Koman janë hartuar referuar standarteve IEC/EN dhe parametrave elektrike të tensionit dhe ngarkesave në HEC Koman. Në përmbushje të objektit të specifikimeve teknike, është kërkuar ndërrimi i teknologjisë për impiantin 6kV në HEC Koman, nga çelësa me gaz SF6 në çelësa me vakum, për shkak se impianti ndodhet në të njëjtin ambjent ku qëndrojnë operatorët, gjë e cila është e dëmshme për shëndetin e punonjësve. Gjithashtu, për të përmirësuar kushtet e mirëmbajtjes, është specifikuar që çelësat të jenë të tipit karroce dhe jo fikse siç janë ekzistueset.

Në impiantin ekzistues janë të instaluara dy fidera në një çelës. Për të zbatuar normat teknike në impiantin e ri, është kërkuar një çelë më tepër në mënyrë që çdo fider të ketë një çelës të dedikuar.

Realizimi i të gjitha këtyre ndryshimeve do të sjellë ndryshime në sinjalizim dhe llogjikën e kontrollit, në sistemin e kontroll monitorimit të HEC Koman. Si pasojë e këtyre ndryshimeve, në specifikime teknike janë parashikuar edhe punime për konfigurimin e sinjaleve të reja me PLC-të dhe SCADA të HEC KOMAN.

Në kuadër të punimeve që do të realizohen në SCADA, në specifikime teknike është përfshirë edhe përmirësimi i mbrojtjeve rele me sistem të monitorimit të qarkut të stakimit, si një funksion shumë i domosdoshëm për të garantuar gadishmërinë e çelësave për stakim në rast avarie. Gjithashtu, do të integrohen edhe sinjalet e çelësave të rinj me karikim me sustë, pasi ato ekzistuese janë me karikim me sistem hidraulik me vaj.

## **Njësia e Prokurimit**